



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRI

Numri i lëndës: 2024:051617

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05639108

P.nr.34/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurës A.H. nga Komuna e Skenderajt, me vendbanim në Fushë Kosovë, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 dhe të pandehurve V.Sh. nga Fushë Kosova, dhe A.H. nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.1883/23 e datës 13.02.2024 pas përfundimit të shqyrtimit fillestar publik të mbajtur me datë 29.04.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurorja e Shtetit Albana Parduzi, të pandehurit A.H. dhe V.Sh. si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar V.P., më dt.29.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

TË PANDEHURIT:

1. A.H. nga i ati N., e ëma B., e gjinisë I., e lindur më datë... në Komunën e Skenderajt, ndërsa jeton në Fushë Kosovë, me numër personal ..., ka të kryer shkollën fillore, e pa punë, jeton në bashkësi jashtëmartesore, e gjendjes së dobët ekonomike, më parë e pa gjykuar, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

2. V.Sh. nga i ati Sh., e ëma I., e gjinisë F., i lindur më datë ... në Prishtinë, ndërsa jeton në Fushë Kosovë, me numër personal ..., ka të kryer tre klasë të shkollës fillore, punon herë pas here privat, jeton në bashkësi jashtëmartesore, i gjendjes së dobët ekonomike, edhe më parë i gjykuar, ashkali, Shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTORE

I. E PANDEHURA E PARË A.H.:

SEPSE: Me datë 27.10.2023, në rrugën “Tahir Sinani”, në Vushtrri, saktësisht në marketin “E...”, e pandehura me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, ia merr pasurinë të dëmtuarës, në atë mënyrë që nga raftet e marketit merr 550 argeta, në vlerë

520 euro dhe 120 sallamë, në vlerë 135 euro, me të cilin veprim të dëmtuarës i shkakton dëm material në shumën prej 655.00 euro.

- Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 të KPRK-së.

II. TË PANDEHRURIT V.Sh. dhe A.H.:

SEPSE: Me datë 31.10.2023, në rrugën “Tahir Sinani”, në Vushtrri, saktësisht në marketin “E.”, të pandehurit në bashkëkryerje, me dashje dhe me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete, ia marrin pasurinë të dëmtuarës, në atë mënyrë që nga raftet e marketit marrin një kaçkavall Edam 45% 3.48 kg, një kaçkavall Edam 3.45 kg, një palë atlete dhe një shall për meshkuj, me të cilin veprim të dëmtuarës i shkakton dëm material në shumën prej 60.67 euro.

- Me këtë në bashkëkryerje ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 43, 69, 70 dhe nenit 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 242, 364 dhe 449 të KPPK-së, i

G J Y K O N

TË PANDEHURËS SË PARË: A.H. për veprën e parë si në dispozitivin I të këtij aktgjykimi i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë (1000) euro, i cili dënim me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen veprën penale në periudhën verifikuese në periudhën prej dy (2) viteve.

TË PANDEHURËVE: V.Sh. dhe A.H., secilit veç e veç iu shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj, i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej njëmijë (1000) euro, i cili dënim me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse të pandehurit nuk kryejnë vepra penale në periudhën verifikuese prej dy (2) viteve.

Me aplikimin e nenit 76 të KPRK-së, të pandehurës A.H. i:

SHQIPTON

DËNIM UNIK ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe DËNIM ME GJOBË në shumën prej dymijë (2000) euro, i cilat dënime me gjobë nuk do të ekzekutohen nëse e pandehura nuk kryen veprën penale në periudhën verifikuese në periudhën prej dy (2) viteve.

DETYROHET e pandehura e parë A.H. që në emër të kompensimit të dëmit palës së dëmtuar

E. t'ia paguajnë shumën e dëmit në vlerë prej 655 euro.

DETYROHEN të pandehurit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit secili veç e veç të paguajnë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor secili veç e veç të paguajnë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsyetuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.1183/23 e datës 13.02.2024, kundër të pandehurës A.H. Fushë Kosova, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 dhe të pandehurve V.Sh. nga Fushë Kosova dhe A.H. nga Fushë Kosova, për shkak të veprës penale Vjedhja nga neni 313 par.1 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së,

Deklarimi i të pandehurve lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit fillestar të mbajtur më dt.29.04.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, gjyqtari i vetëm gjykues pasi bindet se të pandehurit e kanë kuptuar aktakuzën, të njëjtëve i ofron mundësinë e deklarimit rreth fajësisë, ashtu që:

E pandehura e parë A.H. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër si dhe është e gatshme të kompensojë dëmin e shkaktuar.

I pandehuri i dytë V.Sh. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale, duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të kësaj natyre apo natyrës tjetër si dhe është i gatshëm të kompensojë dëmin e shkaktuar.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurorja e shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e tyre, pasi që ka vlerësuar se një pranim i tillë është në përputhje me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë si dhe i ka propozuar gjykatës që pranimin e fajësisë ta merr si rrethanë lehtësuese.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar V.P. lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve ka deklaruar se e pranon pranimin e fajësisë dhe njëherit kërkon kompensim dëmi në vlerën sic është përshkruar në aktakuzë.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin fillestar, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga të pandehurit, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se të pandehurit e kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga të njëjtit, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Procesverbali i marrjes në pyetje të dëshmitarit V.P. në SP Vushtrri i datës 31.10.2023, Tabela që përmban llogaritjen e dëmit, Vërtetimi mbi kthimin e sendeve të sekuestruara përkohësisht i datës 31.10.2023, Pesë fotografi, Video-incizimi, Procesverbali për intervistimin e të pandehurit V.Sh. në SP Vushtrri i datës 31.10.2023 si dhe procesverbali për intervistimin e të pandehurës A.H. në SP Vushtrri i datës 31.10.2023.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se e pandehura e parë me dashje ka kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 dhe në bashkëkryerje me të pandehurin e dytë V.Sh. kanë kryer veprën penale Vjedhja nga neni 313 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK -së në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 313, par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale e kryen “*Kushdo që personit tjetër ia merr pasurinë e cila vlerësohet në shumën prej pesëdhjetë (50) Euro apo më shumë, me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm për vete apo për personin tjetër, dënohet me gjobë dhe me burgim deri në tre (3) vjet.*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurit t’i shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Vjedhja nga neni 313 par. 1 të KPRK -së, ngase veprimet e të njëjtëve përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat janë edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana rënduese sa i përket të pandehurës së parë ka gjetur shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale duke marrë për bazë faktin se lokali ka qenë nën vëzhgimin e kamerës, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurës, gatishmërinë për kompensimin e dëmit, premtimin e të njëjtës se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, pendimin e saj për kryerjen e veprës penale, gjendjen ekonomike si dhe faktin se e njëjta në kohën e kryerjes së veprës penale ka qenë madhore e re, përkatësisht 19 vjeçare si dhe më parë nuk ka kryer vepra penale, ndërsa si rrethana rënduese sa i përket të pandehurit të dytë gjykata ka gjetur shkallën e lartë të dashjes për kryerjen e veprës penale duke marrë për bazë faktin se lokali ka qenë nën vëzhgimin e kamerës, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, si dhe faktin që edhe më

herët ka qenë i gjykuar dhe atë me aktgjykimet P.nr.988/22 dhe P.nr.165/23 ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit gatishmërinë për kompensimin e dëmit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale, pendimin e tij për kryerjen e veprës penale si dhe gjendjen ekonomike.

Sipas bindjes së gjykatës, sa i përket të pandehurës së parë dënimi unik me burg në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me gjobë në shumën prej dymijë (2000) euro, i cili dënim me gjobë nuk do të ekzekutohet nëse e pandehura nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në periudhën prej dy (2) viteve, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurës. Gjithashtu sa i përket të pandehurit të dytë, dënimi me burgim në kohëzgjatje prej dymbëdhjetë (12) muaj i cili dënim do të ekzekutohet pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi dhe dënimi me gjobë në shumën prej dymijë (2000) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese prej dy (2) viteve, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këto dënim të shqiptuara ndaj të pandehurve do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtëve nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore – juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit.

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: “Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 6 paragrafi 1 pika 1.5 dhe nenin 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Numri i lëndës: 2024:051617
Datë: 30.04.2024
Numri i dokumentit: 05639108

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.34/2024, datë 30.04.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimet të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.